



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1013/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lavdije Berisha, kandidate për antare të kuvendit komunalë në Rahovec, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunalë, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lavdije Berisha kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Rahovec nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Lavdije Berisha kandidate për anëtarë të kuvendit komunal nga subjekti politik (PDK) në Rahovec, në të cilën pretendon se me rastin e zgjedhjeve komunale me dt.03 nëntor, kandidatja për asamblë komunale e PDK-së me numër 29, kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këto qendra votimi: Dejnë, Qifllak, Drenovc dhe Vrajakë si dhe mendon se me votat e saj kanë bërë manipulime të shumta dhe shpreson që kërkesa e saj të hasë në mirëkuptim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1013/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.